



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1337/3 Prot.

Tiranë, më 11 . 11 . 2025

V E N D I M

Nr. 257, Datë 11 . 11 . 2025

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja b), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr. 200 Regj., datë 22.09.2025, paraqitur nga znj. F. Xh³, kundër Shkollës së Mesme Profesionale “Irakli Terova”, Korçë, dhe Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI-t), në të cilën pretendohet për diskriminimin e vajzës, A. Xh, për shkak të “moshës” dhe “aftësisë së kufizuar⁴” .

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues shprehet se: *“Jam nënë e tre fëmijëve. Kam një vajzë e cila është diagnostikuar me çrregullime të spektrit autik.*

Vajza ime në muajin qershor 2025 mbaroi sistemin shkollor 9-vjeçar. Në muajin gusht 2025 kam aplikuar në e-Albania ku kam bërë regjistrimin e vajzës për në Shkollën e Mesme Profesionale “Irakli Terova”, Korçë. Dua që fëmija im të arsimohet si gjithë fëmijët e tjerë dhe të jetë e integruar në shoqëri. Kam bërë shumë përpjekje që ajo të futej në sitemin 9-vjeçar.

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

³ Në cilësinë e prindit të fëmijës A. Xh.

⁴ Referuar Vërtetimit të KMCAP respektive, A. Xh është diagnostikuar me xxxxxxxxxx.

Në shtator kam shkuar për të çuar vajzën në shkollë, por nga ana e drejtuesve më është thënë që duhet të verifikojnë ca dokumente.

Problemi qëndron se në muajin shtator vajza ime ka mbushur moshën 19 vjeç dhe kjo e penalizon për të vazhduar shkollës e mesme, pasi ligji për arsimin nuk e lejon që në këtë moshë të vazhdojë shkollën me shkëputje nga puna. Vajza është në vazhdimësi të arsimit të saj, pasi sapo ka përfunduar arsimi 9-vjeçar dhe automatikisht duhet të kalojë në atë të mesëm. Mendoj që në këtë rast nuk duhet të merret në konsideratë mosha dhe ky fakt të përbëjë problem.

Fëmija ime po e vuan psikologjikisht dhe emocionalisht këtë përjashtim pasi asaj i pëlqen të frekutojë shkollën.

Kudo filtet për integrimin e fëmijëve dhe personave me çrregullime të spektrit autik (AK) dhe përfshirjen e tyre në shoqëri, por, nga ana tjetër nxirren pengesa të tilla që ua pamundësojnë efektivisht atë.”

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, marrjen e masave të menjëhershme për regjistrimin e fëmijës së saj në Shkollën e Mesme Profesionale “Irakli Terova”, Korçë, në mënyrë që vajza të ndjekë procesin mësimor si gjithë nxënësit e tjerë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi apo mosveprimi si të një autoriteti publik, ashtu edhe çdo personi fizik apo juridik që merr pjese në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrotjtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrotjtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 1337/1 prot., datë 06.10.2025, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga ana e Shkollës së Mesme Profesionale “Irakli Terova”, Korçë⁵, lidhur me pretendimin e palës ankuese.
2. Nëpërmjet shkresës me nr. 330/2 prot., datë 09.10.2025, Shkolla e Mesme Industriale “Irakli Terova” Korçë, ka njohur Komisionerin me qëndrimin e saj, duke depozituar parashtrimet dhe dokumentacion shkresor. Në parashtrimet e saj, Shkolla, ndër të tjera, sqaron se:

“Mirëkuptojmë dëshirën e prindit dhe të drejtën e fëmijës për vazhdim shkollimi, por Shkolla mori të gjitha masat brenda kompetencave që i lejon legjislacioni për arsimin parauniversitar për të realizuar këtë shkollim.

Bëjmë me dije se:

Aplikimi në sistemin SMIP bëhet nga vetë prindi në e-Albania, por prindi kërko mbështetjen e Shkollës pasi nuk po realizonte dot regjistrimin. Mësuesi koordinator i sistemit SMIP për Shkollën bëri aplikimin në prani të prindit dhe rezultoi se aplikimi nuk pranohej. U përsërit disa herë aplikimi në prani të prindit, i cili ishte në dijeni të faktit që problemi qëndronte në mospranimin e aplikimit nga vetë sistemi.

Mësuesi koordinator i Shkollës njoftoi Suport SMIP-in për rastin dhe më datë 06.10.2025, u arrit të zgjidhej problemi.

Nxënësj A. Xh është e regjistruar në klasën e 10-të të Shkollës Profesionale “Irakli Terova” Korçë.”

3. Ne vijim te procedurat se shqyrtimit te ankeses kundër Shkollës, si dhe në zbatim të parimit të barazisë së armëve për një proces të drejtë e të paanshem, nëpërmjet e-mailit palës ankuese i janë dërguar për njohje parashtrimet e depozituara nga ana e Shkollës; e cila ka konfirmuar se konsideron të zgjidhur problematikën e fëmijës së saj dhe tërhiqet nga ankesa pranë KMD-së.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, qëllimi për të cilin procedimi administrativ ka filluar mbi bazën e ankesës së palës ankuese është përmbushur në thelb, si dhe nisur nga fakti se vetë ankuesja është tërhequr nga ankesa, pasi duke qenë se fëmija i saj është regjistruar në Shkollë, konsideron të arritur qëllimin e ankuesës së paraqitur pranë KMD-së.

Në këto kushte, Komisioneri gjykon se, qëllimi për të cilin është filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrotjtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet: “Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit

⁵ Shkresa u është dërguar për dijeni edhe: MEKI-t, AKPA-së, AKAFPK-së.

Adresa: Rruga “Durrësit”, Nr. 27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, E-mail: info@kmd.al, Web: www.kmd.al

kundër së cilit është paraqitur ankesa”, Komisioneri vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është paraqitur ankesa.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet: *“3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.”*

Në nenin 90/3 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet përfundimi i procedurës administrative: *“Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.*

Në nenin 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, përcaktohet: *“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.*

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, procedura administrative për shqyrtimin e ankesës nr. ankesën me nr. 200 Regj., datë 22.09.2025, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar dhe moshës, të fëmijës A. Xh, nga Shkolla e Mesme Industriale “Irakli Terova” Korçë, duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se pala ankuese është tërhequr nga ankesa, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore⁶.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe nenet 32 e 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 200 Regj., datë 22.09.2025 të F. Xh⁷, pa një vendim përfundimtar, për shkak se pala ankuese është tërhequr nga ankesa⁸, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.

⁶ Për analogji citojmë vendimin nr. 178, datë 04.06.2024, të KMD-së.

⁷ Në emër të fëmijës së saj A. Xh.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA